

TË GJITHË FITOJNË, KUR TI RICIKLON!

**Secilën herë që
depoziton ambalazhe
ose një gazetë për
riciklim, ndodhë diçka e
madhe.**

Kapakët e shisheve të vjetra, mund të konvertohen në llamarinë të re, për makina. Një kuti bosh e detergjentit të rrobave, bëhet, për shembull, një kuti e re për picë. Gazeta e djeshme, bëhet gazetë e re e së nesërme. Materialet e papërpunuara të natyrës përdoren sërish dhe kursehet shumë energji. Në këtë mënyrë, ne ndihmojmë në krijimin e një bote më të mirë, të jetojmë në të.

RICIKLIM

Mbeturinat ushqimore si bio gaz dhe bio plehra dhe mbetjet e mbeturinave bëhen energji elektrike dhe ngrohje. Të gjitha ambalazhet dhe gazetat që grumbullohen, çohen për riciklim, që të bëhen ambalazhime të reja ose produkte të reja. Ambalazhi plastik, bëhet lëndë e parë, për shembull, për qese bartëse plastike dhe enë kategorizimi. Ambalazhet e qelqit dhe të letrës, ato shpesh bëhen serish ambalazhe. Ambalazhi prej metali, mund të bëhet disk makine, kurse gazetat e lexuara, mund të bëhen letër kuzhine ose letër e re për gazeta.

DHOMA MJEDISI DHE STACIONE RICIKLIMI

Mbeturinat ushqimore dhe mbetjet e mbeturinave, duhet të lihen në një kazan të veçantë plehrash, aty ku ti banon, p.sh. në dhoma mjedisi. Nëse ti nuk mund të lësh ambalazhet ose gazetat, aty ku ti banon, atëherë ato duhet të lihen në stacionet e riciklimit pa personel. Këtu ka fuçi, për çdo lloj ambalazhi: plastikë, letër, metal dhe xham, shpesh edhe gazeta. Ambalazhet e mëdha, të cilat nuk i zë kazani i plehrave, aty ku ti banon, ato mund të lihen në stacionet e riciklimit ose në qendrat e riciklimit.

MË SHUMË INFORMACION

Në www.sopor.nu, mund të gjeni pikën më të afërt të riciklimit dhe të kontrolloni, se kur boshatiset dhe pastrohet. Këtu, po ashtu, ka udhërrëfyes kategorizimi, filma mbi riciklimin, informacion dhe këshilla, për kategorizimin burimor.

Nëse ti ke pyetje për mbeturinat dhe për riciklimin, mund të kontaktosh komunën tënde. Ata, po ashtu, mund të përgjigjen në pyetjet për mbeturina me përmasa të mëdha, përzierje plehrash, mbeturina elektrike dhe mbeturina të tjera.

KATEGORIZO MË SHUMË!

Për të bërë të mundur që të riciklohen sa më shumë mbeturina, ne na duhet ndihma juaj.

- Mos i përziej mbeturinat e ndryshme.
- Mbeturinat ushqimore, duhet të vendosen, vetëm në qesen e veçantë, që ju ndahet, për këtë gjë.
- Mbetjet e mbeturinave, duhet të vendosen në një qese, të cilën e lidhë mirë.
- Ambalazhet duhet të jenë të boshatisura dhe deri diku të thata. Nëse keni ambalazh të përbërë nga më shumë se një material, duhet ta kategorizoni sipas materialit që ju mendoni se peshon më shumë.



- ✓ Fruta dhe mbetje zarzavatesh, qese të çajit, llum kafeje, lëvozhga vezësh, kockë me mish dhe të ngjashme. Shkon mirë edhe pak letër kuzhine.
- ✗ Plastikë, burnot, cigare, lule dhe qirinj, nuk janë mbeturina ushqimore.



- ✓ Shishet, kanoçet, qeset plastike, paketat rimbushëse, tubat plastike, paketat e patatinave dhe poliestiroli. Hiqni çdo tapë ose kapak. Boshatisni qesen tuaj me ambalazhin plastik, në enët e ndryshme për secilën. Kjo e bën më të lehtë punën në fazat e mëvonshme të riciklimit.
- ✗ Produktet e tjera plastike përveç ambalazhit, duhet të lihen si mbetje me përmasa të mëdha ose mbetje shtëpiake, p.sh. mobiliet dhe lodrat. Shishet e depozitimit, duhet të kthehen në një dyqan, për rimbursim.



- ✓ Kanoçe konservash, kanoçe të boshatisura të spërkatjes, tubat, kapakët e shisheve, kapakët dhe kutitë e boshatisura të bojës. Palosini brenda kapakët e mprehtë të kanoçeve prej metali.
- ✗ Kanoçet që kanë mbetje boje ose ngjitesi, duhet të lihen si mbeturina të rrezikshme. Skrapi metalik, pjesët e mbetura të punimeve hidraulike dhe produktet e tjera që nuk janë ambalazhime, duhet të lihen si mbeturina me përmasa të mëdha ose mbeturina shtëpiake. Kanoçet e depozitimit, mund të kthehen në një dyqan, për rimbursim.



- ✓ Kutitë e makaronave, të qumështit dhe lëngjeve, qeset prej letre, kutitë e këpucëve, rolet e letrës higjienike dhe kutitë prej kartoni. Sheshojini dhe palosini në dysh. Vendosini ambalazhet e vogla brenda ambalazheve të mëdha, për të kursyer hapësirë.
- ✗ Zarfet duhen klasifikuar si mbetje shtëpiake ose mbeturina të djegshme. Gazetat, fletëpalosjet e reklamave dhe sendet e ngjashme, duhen lënë në enët për gazetat.



- ✓ Gazetat ditore dhe javore, revistat, katalogët, fletëpalosjet e reklamave, broshurat, librat e xhepit dhe letrat e shkrimit/vizatimit. Hiqni qeset prej plastike si dhe etiketat e reklamimit.
- ✗ Zarfet dhe librat e lidhura, duhen lënë si mbeturina shtëpiake ose mbeturina të djegshme. Qeset prej letre, kartonët dhe sendet e ngjashme, lihen në enët, për ambalazhet prej letre.



- ✓ Shishet dhe kavanozat prej qelqi me ngjyrë ose të tejdukshëm. Hiqni kapakët e tapat dhe kategorizoni ato, sipas materialit përkatës. Kategorizo ambalazhin e qelqit me ngjyrë dhe të tejdukshëm, në enën e duhur.
- ✗ Shishet depozituese duhen kthyer në një dyqan për rimbursim. Porcelani, qeramikat dhe produktet e tjera që nuk janë ambalazhim, duhen kategorizuar si mbeturina me përmasa të mëdha ose mbeturina shtëpiake. Llambat dhe neonet zakonisht duhen çuar në qendrat e riciklimit me personel të komunës.



- ✓ Pelena, zarfe, leckë enësh, burnot, furça dhëmbësh si dhe flokë nga furçat e flokëve.
- ✗ Asgjë që mund të riciklohet, nuk duhet vendosur në plehrat e zakonshme! Mbeturinat e rrezikshme si dhe mbeturinat elektrike, as ato nuk duhet të përfundojnë në qesen e plehrave, ato duhet lënë në qendrën e riciklimit.

FALEMINDERIT!

sopor.nu
Sveriges avfallsportal